



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:075661
Datë: 23.01.2024
Numri i dokumentit: 05229549

C.nr. 1077/23.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm - Departamenti Civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.P, nga Komuna e Pejës, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson F.A, avokat në Pejë, kundër të paditurës K.P, me objekt kontesti Kompensimin e Shujtës, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mesë të palëve ndërgjyqëse në procedurën e ndërmjetësimit, jashtë seance me datë, 23.01.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE** me numër Nd. 92/24 e arritur në Qendrën për Ndërmjetësim në Pejë me datë, 13.01.2024 e lidhur në mes të paditëses L.P, nga Komuna e Pejës, dhe të paditurës K.P, me objekt kontesti Kompensim i Shujtës.
- II.** Pjesë përbërëse e këtij aktvendimi është marrëveshja e ndërmjetësimit Ndr.nr. 92/24, datës 13.01.2024 e cila e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

A r s y e t i m

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datën 27.03.2023, kundër të paditurës, me objekt kontesti Kompensim i Shujtës.

Në Qendrën e Ndërmjetësimit kjo lëndë është referuar me datë, 13.01.2024, palët ndërgjyqës me datën, 13.01.2024, respektivisht të autorizuarit e tyre kanë arritur marrëveshjen për këtë çështje juridiko civile dhe gjykatës i është dorëzuar marrëveshja e arritur në mes palëve ndërgjyqëse, përkatësisht të autorizuarve të tyre.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes se ndërmjetësimit me nr. të referencës Ndr.nr. 92/24, të datës 13.01.2024 e lidhur në Qendrën për Ndërmjetësim në Gjykatën Themelore në Pejë, në mes të autorizuarës të paditësit dhe të autorizuarit të paditurës, me objekt kontesti, Kompensim i Shujtës, (për më tepër sikurse në marrëveshjen e datës, 13.01.2024, pjesë e shkresave të lëndës), vlerëson se kjo marrëveshje i plotëson kushtet ligjore, pasi që kjo gjykatë ka konstatuar se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me ligjin dhe për këtë arsye bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 3.3 dhe nenit, 411, 412 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 2,3, 4,5,6,7,8, 10, 11, 12, 14, 15 par. 1 të Ligjit për Ndërmjetësimin me nr. 06/L-009, erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore duhet të miratohet dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

Nga të lartcekurat, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr. 1077/23 i dt. 23.01.2024

G j y q t a r i

Besnik Shala